

Këngët e bukura e të thjeshta

kapen shpejt nga fëmijët

(Shënime nga Festivali i 13-të kombëtar i këngës për fëmijë e pionierë)

Rozmari Jorganxhi

Tanimë është krijuar një traditë e mirë: vit për vit zhvillohet Festivali kombëtar i këngës për fëmijë e pionierë, i cili, krahas formave të tjera po shërben mjaft për lëvrimin, pasurimin dhe përhapjen me sukses të këtyre llojeve të veçantë kënge në përputhje me psikologjinë dhe mundësitë vokale të degjuesve të vegjël, botën shpirtërore e mendore të cilëve ka kryesisht si objekt, dhe për të cilët krijohet Festivali i 13-të kombëtar i këngës për fëmijë e pionierë, që u zhvillua pak ditë më parë në Shkodër, erdhi dhe do të mbesi në radhën e këtyre aktiviteteve të rëndësishme artistike muzikore të vendit me karakteristikat e veta, me specifikën e vet.

Të 24 këngët e kënduara në këtë festival u zgjodhën nga rreth 450 këngë të ekzekutuara në të gjithë rrethet e vendit, në muajt e parë të këtij viti. Tërë kjo krijimtari e bollshme u frymëzua dhe u krijuar në atmosferën e gjallë të jetës, të luftës e të punës të masave tona punonjëse që kanë ndezur vendimet e plenumeve të IV, V dhe VI të KQ të Partisë, si dhe fjala e shokut Enver Hoxha e 20 dhjetorit të vitit të kaluar. Debutuan në skenat tona me qindra talente të reja nga radhët e fatosave e pionierëve si këngëtarë dhe ekzekutues (në orkestra dhe në formacione me instrumenta popullore). Pjesëmarrje e madhe u vu në këtë vit edhe në radhët e krijuesve të rinj kompozitorë amatorë e poetë. Bile numri i tyre në Festivalin e 13-të kombëtar në Shkodër, që u imponuan me këngët e veta për tematikën e shëndoshë e realizimin e lartë artistik si dhe për tingëllimin popullor e kombëtar, ishte shumë më i madh, zotëruar, në krahasim me atë të shokëve të njohur e profesionistë. Dhe kjo erdhi kryesisht nga ai vërshim i madh i talenteve të reja; megjithëse shokët krijues, profesionistë u angazhuan, gjithashtu, si në asnjë vit tjetër, duke dhënë këngët e tyre më të bukura. Një dukuri e tillë dëshmon më së miri për punën e kujdesshme të organeve të Partisë e të pushtetit në rrethe e në kryeqytet. U duk qartë, gjithashtu, ky kujdes edhe në krijimin e kushteve të duhura nga organizuesit e festivalit në Shkodër dhe nga interesimi i vazhdueshëm edhe i rrethëve të tjera.

Këto përpjekje të gjithanshme u konkretizuan me këngët e goditura e të realizuara në përgjithësi mirë artistikisht, që u kënduan në këtë festival, me zbulimin e një sërë talentesh të reja që marrin tanimë stafetën e revolucionit dhe të artit tonë të realizimit socialist.

Kënga jonë për fëmijë e pionierë ashtu si kënga jonë në përgjithësi vihet re se, sidomos këto tre vitet e fundit, po zgjidh e vë plotëson çdo ditë më tepër e

më mirë kërkesat kryesore që kanë ndaj saj masa e degjuesve të vegjël. Dihet se kjo lloj kënge krijohet dhe ekzekutohet në përshatje me moshën dhe psikologjinë e degjuesit, i cili edhe do ta këndoje, «do ta mbajë tërë ditën në buzë», siç e kemi bërë zakon të shprehemi në të tilla raste. Dhe për t'ia arritur këtij qëllimi të domosdoshëm mendojmë se në këngët e Festivalit të 13-të kombëtar për fëmijë e pionierë është bërë një punë e suksesshme.

fëmijët. «Me Partinë e Punës» titullohet kënga e T. Daisë me tekst të M. Kriqit, e cila u ndërta me çmim të parë. Është një këngë e bukur që të bën të menjosh për disa kërkesa që kanë zgjidhur autorët, duke realizuar artistikisht një krijim të tillë që ka si objekt pasqyrimi ndjenjën e reale e të thellë të fëmijëve tanë, dashurinë për Partinë.

Një tjetër faktor, që e afron më shumë këtë këngë me masën e fatosave e të pionierëve, është



Në Festivalin e 13-të kombëtar të këngës për fëmijë e pionierë.

Ra në sy në mënyrë të dukshme përpjekja për një gamë të gjërë tematike të këngëve në festival. Ajo ishte e shëndoshë dhe e larmishme, e gjetur në përputhje me interesat e vetë fëmijëve e pionierëve, si edhe me vlera për edukimin e tyre klasor, revolucionar, me dashurinë për Partinë, shokun Enver Hoxha, Atdheun socialist, për heronjtë e Luftës Nacionalçlirimtare, punën, prindërit, shokët e shkollës e gjithçka tjetër që i rrethon ata në gjirin e ngrohtë të shoqërisë socialiste ku rriten dhe edukohen me idealin e revolucionit. Është meritë e shokëve krijues, poetë e kompozitorë që përmes subjekteve të thjeshta e fabulave konkrete, të gjalla dhe jetësore kanë ditur të trajtojnë me partishmëri të lartë e vërtetësi artistike këto tema kaq të dashura për fëmijët tanë. Shpesh vargjet e thjeshta, por të ndërta, e të ngjeshur me mendime, që janë reale e të vetë botës së fatosave e pionierëve, janë bërë shkak e kanë frymëzuar kompozitorët, për të dhënë një material muzikor gjithashtu të thjeshtë, të qartë e të kapshëm për

edhe tingëllimi i saj i theksuar popullor e kombëtar. Kënga nuk është bërë duke u nisur nga ndonjë motiv i veçantë, por ajo e tëra është brenda atmosferës së këngëve tona popullore, gjë që vjen si rezultat i njohjes dhe asimilimit të kësaj krijimtari nga autori.

Kënga me «Partinë e Punës» dallohet për një ndërtim të thjeshtë dhe shprehje vokale të përshtatur diapazonit të fëmijëve. Kjo e bën atë veçanërisht të kapshme e të këndueshme për fëmijët dhe pionierët. Sigurisht në festival pati edhe këngë të tjera, që u shquan si për tematikën e tyre interesante, ashtu edhe për tingëllimin e theksuar popullor e ndërtim të thjeshtë muzikor. Të tilla janë, p.sh., këngët «Dc ja themi këngës», me tekst e muzikë të kompozitorit të ri amator Y. Lames, «Fesa e abetares», me tekst të A. Zekës dhe muzikë të B. Danit, «Rreze dielli Shqipëria jonë», me tekst të Ll. Siliqit e muzikë të Ç. Zacesë, «Një tufë lule» e P. Gacit, me tekst të Ll. Nanos etj. Dhe janë pikërisht këto këngë që për të tre këto karakteristika të qarta, që kishin, u kapën shpejt dhe u përhapën qarta në ditët e

festivalit në masën e fëmijëve në sallë e jashtë saj. Por a ndodhi me të gjitha këngët kështu?

Mendojmë se jo. Kishte në këtë festival edhe disa këngë si «Komisari», «Tregimi i gjyshit veteran» etj., të cilat ishin me emocione dhe bartnin ide interesante, por që për shkak të shtrirjes së madhe (mbi mundësitë vokale të fëmijëve) nuk kapen dot e nuk këndohen nga masa e fatosave dhe e pionierëve. Ndokush mund të mendojë, se nuk është e thënë, që të gjitha këngët për fëmijë të jenë të tilla që mund të këndohen nga ata. Është e saktë, fëmijët kanë nevojë edhe për këngë të bukura të tipit koncertal, që mund të këndohen nga solistë të zgjedhur. Por kryesorja në këtë çështje është që të kemi një raport sa më të drejtë mes këngës koncertale për fëmijë dhe asaj që kapet e këndohet nga ata. E theksojmë këtë, sepse pavarësisht nga sukseset që vihen re në krijimtarinë e këngës për fëmijë për t'ia arritur një qëllimi të tillë mbetet ende shumë për t'u bërë nga forcat tona krijuese profesioniste dhe amatore.

Duke ngritur këtë problem, dëshirojmë të shtojmë, se ai nuk duhet trajtuar e zgjidhur si diçka në

vetvetë, përkundrazi. Kërkesa për më shumë këngë të thjeshta e të tipeve të ndryshme që të këndohen nga fëmijët është një kërkesë që nuk mundet e nuk duhet veqar nga tërë kompleksi i kërkesave ideestetike për këtë lloj të veçantë kënge, ashtu si për krejt këngën tonë në përgjithësi. Sepse vetë fëmijët tanë një këngë që do të dallohej vetëm për ndërtimin e thjeshtë e shtrirjen e saj vokale brenda diapazonit të tyre, pa patur ndonjë temë interesante e të trajtuar me vërtetësi artistike, pasi do ta mësonin shpejt, gjithashtu do ta harronin shpejt. Pra sekreti i këngëve më të mira për fëmijë, që janë krijuar tek ne deri më sot, ashtu edhe i atyre që u kënduan në këtë festival, është se ato, krahas tematikës së shëndoshë e trajtimit të tyre artistik me partishmëri të lartë, dallohen njëkohësisht edhe për tingëllimin e thjeshtë e shtrirjen vokale përshtatur mundësive dhe diapazonit të fëmijëve.

Këngët e Festivalit të 13-të kombëtar për fëmijë e pionierë dallohen edhe për një tingëllim të

(vijon në f. 7)